



## QENDRIMET E PADREJTA TE GREKEVE DHE POZICIONI I ALB-SHKENCES NE KETE DISKUTIM

Shkak për këtë shkrim u bënë reagimet e shumta e të drejta të shumë anëtarëve të Alb-Shkencës pas provokimit të radhës të shoqatave të ndryshme greko-amerikane me pretendimet e tyre të pa argumentuara lidhur me minoritetin grek në Shqipëri.

Një nga zërat shqiptarë që u ngrit menjëherë për të protestuar kundër shpifjeve greke ishte ai i Gary Kokalarit, një shqiptaro-amerikan që edhe në raste të tjera të ngjashme ka bërë denoncimin e tij edhe pse për shumë nga ne me një gjuhë jo shumë të përshtatshme e të kontrolluar. Pavarësisht nga leksiku i përdorur nga Kokalari shumica e anëtarëve të forumit tonë shkencor ishin në një mendje me kundërvënien ndaj pretendimeve të tyre shoviniste por duke e bërë këtë njëkohësisht efikase e të argumentuar.

Ishte **Mirela Bogdani** që solli lajmin e protestës së shoqatave greke dhe përgjigjen e ndezur të Gary Kokalarit (e përmbledhur këtu në të djathtë). “*Ndërkohë që gjithë vendet e Europës – shkruan ajo – të pasur e të varfër, të mëdhenj e të vegjël, të të gjitha feve, po integrohen në njësinë e përbashkët të BE-së, grekët vazhdojnë me pretendime arkaike territoriale të Epirit Verior dhe me ëndërrime helenizimi. Dhe nuk e di përse historikisht gjërat vdesin ti arrijnë me prapaskena e manipulime. Po ç’të bësh që qeveria jonë është jo vetëm pa kurajo për t’iu kundërvënë qendrimeve të tilla, por është dhe filo-greke, servile deri në dhimbje, në lëshimet*

*To Gene Rossides*

*President of American Hellenic Institute*

*c/o Georgia Economou, 1220 16th Street, Washington, DC*

*Dear Mr. Rossides,*

*It’s amazing how you Greek gomars love to kick a weak person when he’s down, and to add insult to injury, you then try to rob him of what few possessions remain. This is a perfect analogy for what the Greek chauvinist scum is trying to do to Albania. But after all, this is the Greek way. People like your pig of a friend, Nick Gage, in my opinion among the lowest form of scum on earth, continue to perpetuate myths about Albania’s Greek minority. Let me state that because a person is orthodox, despite the feeble attempts of Greek chauvinists like you to twist the truth, this does not change an individual’s ethnic heritage to Greek, thank God, because in my opinion, that would be a fate worse than death. Yet, you insist on trying to distort Albania’s demography in a pathetic attempt to reach your reprehensible and highly transparent objectives. Fortunately, the US and EU are well aware of your games and know the true situation despite your repeated attempts to distort the picture, and I am proud to say that I have contributed to these efforts. As for the conditions of Albania’s Greek minority, which numbers well below 50,000, they are no worse off than the Albanians, and in many ways, in relative terms, they live under much better conditions. They have better schools, disproportionately high representation in Parliament, hold positions as ministers (even though Economy Minister Angjeli, one of your own, is a fat little pig who can’t keep his hands out of the cookie jar), they have instruction in their treasured Greek tongue (in my opinion, a guttural tongue), and villages with large Greek populations have public signs in Greek. Now please tell me, for the hundreds of thousands of ethnic Albanians in Greece, where are the Albanian signs? And where are the Albanian schools in Greece? And how many Albanian ministers are there in Greece? And how many Albanians are permitted to vote in Greece? And why is it that Greeks insist on forcing their vulgar language and names upon Albanians with that unique Greek form of ethnic cleansing known as hellenization?*

*You would be well advised to be more concerned about your precious and vulgar Greek history and how your brethren massacred tens of thousands of Albanian Chams, including innocent women and children, during World War II. Then, in classic Greek style, after committing genocide, your noble Greek brethren stole the lands and homes of the Chams while their corpses rotted. And of course we can’t forget how also during World War II, when Albania was under Nazi occupation, and all of the Jews who fled to Albania, many from Greece, were provided safe harbor. Those noble Albanians risked their lives to protect Jews who were visitors to their homes. This stands in stark contrast to the status of the Jews of Greece during this same period. Prior to the war, there were 72,000 Jews in Greece. Unfortunately, 60,000 of those unfortunate Jewish souls were turned over to the Nazis on a silver platter so they could be escorted to gas chambers. I hope you and your people are proud of this history.*

*There is an old saying, “people who live in glass houses shouldn’t throw stones.” And there is no bigger glass house in the world than the country known as Greece. I suggest you deal with the blatant Greek racism toward Albanians and other minorities in Greece before you start throwing stones at others. Please extend my best wishes to Nick Gage, who works against Albanians in the same Greek tradition of his brethren who massacred innocent Albanian Chams and were facilitators of the Holocaust.*

GARY KOKALARI

e pazaret që bëjnë me ta (shih monopolet greke në ekonominë shqiptare). Për këtë më vjen mirë që ka njerëz si Kokalari me guximin t'ia përplasnin në sy dhe të mbrojnë të vërtetën e interesat shqiptare.”

**Eshref Januzaj** shkruan për të përdorur më pjekuri e për ti adresuar protestat tona në organet kompetente amerikane e jo shoqatave greke të cilat e njohin mirë realitetin e vërtetë të minoritetit grek: “Përkundër qëllimit të mirë që do të kishte një reagim i Alb-Shkencës ndaj deklarimeve politike të lobit grek, nuk besoj se do të ishte e qëlluar që ne të merremi me këtë punë. Të paktën jo si komuniteti Alb-Shkenca.

Para se dikush të gjejë qindra arsye kundër kësaj që shkrova më lart (arsye të cilat do t'i gjeja edhe unë), do shtoja se edhe unë jam që të mos heshtet kundër deklarimeve politike në dëm të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Nëse dëshirojmë të reagojmë si komunitet shqiptar në Internet, le të përdorim t'a zemë listën Albanian, që nuk është e veshur me 'petkun' e një liste shkencore por si listë e të gjithë shqiptarëve dhe e atyre që interesohen për çështjen shqiptare.

Më pas edhe shumë anëtarë të tjerë të Alb-Shkencës si **Altin Topi**, **Eno Koço**, **Petra Papajorgji**, **Agim Bacelli** etj. shtruan mendimet e argumentimet e tyre për pozicionin që duhet të mbajë bashkësia jonë mbi këtë problem. Një përshkrim përfshirës e bëri **Lindita Komani** si vijon: “Nuk është as i pari e as i fundit rast që bëhen deklarata të tilla mbi shqiptarët, si kjo që ka shtyrë zotin Kokalari të reagojë ashpërsisht. Por përgjigja shqiptare le gjithmonë për të dëshiruar. Pse? Sepse ajo është e formës operative e jo strategjike. Ajo vjen vetëm si reagim ndaj sulmeve greke, pjesë e një strategjie që qëllon vazhdimisht dhe pa u tutur nga reagimet shqiptare. Dhe kjo është mangësia jonë e madhe. Përgjigja ndaj strategjisë është kundërstrategji. Dhe kjo kërkon angazhim të të njëjtit nivel me atë që bëjnë grekët që pa iu dridhur qerpiku prej dekadash përhapin dokrra për historinë e tyre në Ballkan, për padrejtësitë që iu është dashur dhe iu duhet ende të vuajnë nën shqiptarët.

Strategjia kërkon njerëz që të punojnë së bashku për të njëjtin qëllim; kërkon që këta të mblidhen në një a më shumë institucione që koordinohen mes njeri-tjetrit; kërkon angazhim financiar të diasporës shqiptare. Meqë bëhet fjalë për dokrrat e grekëve në Amerikë, duhet që ky angazhim financiar të ndodhë në Amerikë. Le të krijohet një institut i kulturës shqiptare atje dhe ai të marrë përsipër që shkencërisht të dëshmojë për të vërtetën historike e kulturore, të merret përsipër përkthimi në anglisht i intelektualëve shqiptarë, historianëve, shkrimtarëve mes të tjerëve. Le të mblidhen e të bëhet politikë publiciteti për shqiptarët. E rezultati

nuk duhet pritur sot për nesër, ai mund të vijë vetëm me kalimin e viteve. E kjo kërkon vendosmëri dhe... përsëri financa.

Ndërsa për përgjigjet operative nga ana shqiptare. Ato le të jenë të çdo lloj forme dhe le të vijnë nga çdo drejtim, shkencor dhe jo-shkencor, emocional dhe jo-emocional. Reagimi është reagim. Zoti Kokalari ka guximin dhe durimin të merret me shpifjet, pjesë e strategjisë greke. Ai duhet përgëzuar për këtë. Mbaj mend që në fund të vitit 2003 shkruanin në gazetën NY Times një shkrim se si shqiptarët shesin fëmijët për një televizor. Një shkrim skandaloz, për të cilin sërish z. Kokalari bëri thirrje që të reagonin sa më shumë shqiptarë që të ish e mundur. Ditë më vonë kerkova në seksionin e letrave të NY Times se mos gjeja ndonjë nga letrat që mund të ishin dërguar ose një tërheqje a kërkim ndjese nga ana e artikullshkruesit. Por, asgjë e ngjashme nuk kish ndodhur. Ndoshta ka ndodhur më vonë. Megjithatë edhe shkrime të këtij lloji janë pjesë e strategjisë. A jemi në gjendje t'i bëjmë ne gazetarët amerikanë të shkruajnë pozitivisht për ne? Z. Topi ka shkruar gjerësisht mbi këtë ide. Kjo të jetë pjesë e strategjisë shqiptare.

Një tjetër këndvështrim është ai i zotit Bacelli, që për mendimin tim, ka po aq vlerë e ndoshta dhe më shumë se ç'ka po diskutohet lidhur me politikën greke. Strategjia greke përtej sulmit nga jashtë ka sukses sepse përpjekjet për ta marrë kalanë nga brenda kanë dhënë deri tani rezultat. Mjafton të shohësh se ç'ndodh në Shqipëri, sa ndërmarrje pas privatizimit kanë kaluar në dorë të grekëve, kush e bën politikën në Shqipëri etj. Edhe për këtë strategji greke të marrjes së kalasë nga brenda (me variantin Kali i Trojës) përgjigja duhet me strategji, përtej reagimeve operative “o sa greke e kemi qeverinë”. Kjo strategji kërkon edukimin e brezave shqiptarë, që nga më të rinjtë deri dhe ata më të pjekurit.

**Albana Rexhepaj:** “Ka ardhur koha që ne si një segment i (më) i emancipuar i shoqërisë shqiptare të vendosim standarde të reja e të larta. Një letër proteste nuk duhet të jetë thjesht një letër tjetër proteste; duhet të jetë një letër që t'a nxisë lexuesin ta lexojë deri në fund dhe ta fusë në mendime (ndoshta edhe ta edukojë në mënyrë pasive mbi historinë ose mbi një variant të saj, të paktën).

Problemi që unë personalisht kam pasur dhe kam me këto letra ka qenë pikërisht anashkalimi në to i historisë dhe përqendrimi në përrallat e fabulat nacionaliste lokale, që për fat të keq i kanë frymëzuar dhe kultivuar edhe vetë shkencëtarët shqiptarë: për të mësuar historinë e Shqipërisë ne duhet të lexojmë autorët e huaj. Prandaj sygjërimi im është që, një grup specialistësh të bëjnë një rindërtim të fakteve ashtu siç pranohen sot (e thek-

soj sot) universalisht nga komuniteti i historianëve, jo vetëm shqiptarë, por albanologët e historianët kudo që ata janë, me referimet përkatëse të literaturës. Ky tekst t'i dërgohet jo vetëm medias dhe institucioneve amerikane e greke por edhe atyre shqiptare. Dinjiteti mbrohet vetëm me fakte. Ka ardhur koha të tregojmë që edhe ne dimë ta luajmë lojën e fakteve!”

E ndërsa vendosëm që si Alb-Shkencë të përgatisim një letër proteste e ti japim kohë letërskruerit për të kryer punën e tij, në adresën e forumit tonë filluan të arrijnë shkrime për argumentin në fjalë të cilat kanë edhe referenca të mira në këndvështrimin e fakteve historike. Më poshtë po rendisim disa prej tyre me dëshirën e mirë që të shtohen më tej për ta kompletuar sa më shumë zbulimin e së vërtetës së marrdhënieve shqiptaro-greke.

- Një libër i detajuar e me referenca të shumta është dhe libri **The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present**, McFarland & Company, Inc., Publishers, Jefferson, North Carolina, 1995, ISBN-0899509320 me autor Edwin E. Jacques. Libri është botuar në shqip nga Shtëpia botuese Kartë e Pendë, Tiranë, 1998.

Në diskutimin lidhur me prejardhjen e shqiptarëve autori argumenton prejardhjen e shqiptarëve nga pellazgët. Por ajo që më beri më shumë përshtypje është argumenti lidhur me gjuhën e Homerit. Dihet se grekët e trajtojnë atë si “babai i letërsisë greke” por autori argumenton se gjuha e Homerit nuk është ajo greke, por ajo pellazge. Për më tepër autori argumenton se lufta e Trojës nuk ishte një luftë midis grekëve e trojanëve. “Në të vërtetë vetë Homeri dinte më mirë se kaq. Ai vetë e trajton luftën e Trojës, ashtu siç ishte, një luftë midis fiseve pellazge...”. (Ardian Harri)

- Mbi çështjet shqiptaro-greke ka shkrime shumë profesionale nga të huajt, edhe pse nga udhëtarë intelektualë e jo studjues të mirëfilltë, por që në librat e tyre kanë një informacion e një argumentim mjaft të saktë historik. Po citoj disa prej tyre: Hughes, **Travels in Sicily, Greece and Albania**, London, 1820; Broughton, **Travels in Albania and other Provinces of Turkey in 1809-1810**, London, 1855; Knight: **Albania, a Narrative of Recent Travel**, London 1880; Peacock, **Albania, the Foundling State of Europe**, London 1914; Swire, J. **Albania, the Rise of a Kingdom**, London, 1929. Por edhe Poqueville duhet lexuar përsëri dhe jo siç është përkthyer e copëtuar gjer më sot. Po ashtu Durham që edhe titullin (**Brenga e Ballkanit**) ja kanë përkthyer gabim. Jemi ende në fazën fillestare të mbrojtjes sonë, por do kohë e durim (Eno Koço)

- Spiro Muselimi tek **Istoriko Peripato ana tis Thesprotia** botuar më 1974 dhe ribotuar më 1997

në Janinë midis të tjerash shkruan: “Më 1877 Peshkopi i Çamërisë Grigori detyrohet të përkthejë pjesë të Testamentit të Ri në shqip sepse çamët e krishterë nuk kuptonin asnjë fjalë greqisht”. Po ky autor konfirmon se “në rregjistrimet zyrtare të vitit 1912 në Çamëri nga 70.737 banorë 88% ishin shqiptarë që flisnin vetëm shqip: 31.304 të besimit musliman dhe 29.593 të krishterë”.

- Richard Clogg në **A Concise History of Greece**, botuar në Londër më 1999 pohon se “sipas rregjistrimeve zyrtare greke të vitit 1951 në Greqi ishin 22.736 banorë shqiptarë. Ndërsa më 1973, kryetari i bashkisë së Gumenicës duke folur në gjuhën e nënës, shqip, i tregon ambasadorit shqiptar në Athinë, se midis shumë fshatrave me shqiptarë është karakteristik fshati Kastrizë, afër Gumenicës, me 1800 banorë që flasin vetëm shqip.”

- Norvegjezi Vemund Aarbakke në **Jahrbücher für Geschichte und Kultur Südosteuropas**, botuar më 2002, shkruan se “shumica e luftëtarëve më të njohur në luftën çlirimtare të Greqisë ishin shqiptarë, vllahë ose sllavë”. Këtu është fjala për trimin e Çamërisë Marko Boçari që mbasi i dorëzoi francezit Poqueville fjalorin shqip-frëngjisht më 1802, luftoi bashkë me trimat e tjerë çamë-suliotë për pavarësinë e Greqisë më 1829. (Sali Bollati)

- Andre Gerolymatos në **Red Acropolis. Black Terror** shkruan “Veshja e burrave grekë në shekullin e XIX-të ishte fustanella shqiptare. Ndërsa vallja e mirënjohur Çamiko është prapë shqiptare.”

- Libri **Enigma**, i Robert D'Angély me titullin e plotë **Enigma... origjina e racës dhe e gjuhës së pellazgëve, arianëve, hititëve, helenëve, etruskëve, grekëve dhe shqiptarëve tashmë e zgjidhur** ka 7 vëllime. Pesë vëllimet e para përbëjnë një vështrim historik, etnografik e gjuhësor të këtyre popujve (Botimet Cismonte e Pumonti, 1990-1991) dhe dy vëllimet e fundit përmbledhur në një, përbëjnë një gramatikë shqipe të krahasuar (Solange d'Angély, 1998 - 84, Rue Didot, 75014, Paris).

- **Greqia, dashnorja e perëndimit, gruaja e lindjes**, Robert D. Kaplan, Dituria, Tiranë 2002.

- **Arvanitët dhe shqiptarët në luftën çlirimtare të popullit grek**, Dhimitër Grillo, Sh.B. 8 Nëntori, Tiranë, 1985

- **Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët**, Nermin Vlora Falaski, Sh.B. Faik Konica, Prishtinë, 2002.

- **Histori e Shqipnis**, Tajar Zavalani, Phoenix, Tiranë, 1998.

- **Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve**, Aristidh P. Kolia, Sh.B. 55, Tiranë 2002.

- **Elementi shqiptar në Greqi**, J.P. Fallermayer, Sh.B. Saraçi, Tiranë, ISBN 99927-950-0-X (Vazhdimin e diskutimeve mund ta ndiqni në adresën [www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org))



**P**ërshëndetje, të nderuar!

Më lejoni të parashtoj një kërkesë, të cilën ju lutem e përcillni, nëse e shihni të arsyeshme.

Para një viti filluam projektin, me dy-tre vetë, për të krijuar një bibliotekë virtuale në spiritualitet e albanologji, ku një vend të merituar zë puna përkthimore e Fan Nolit në literaturën ortodokse. Përderisa projekti ynë ([www.ShqiptarOrtodoks.com](http://www.ShqiptarOrtodoks.com)) është zgjeruar tej parashikimeve dhe kërkon plotësim e detajim tej mundësive tona ekonomike, do t'ju lutesha nëse mund të ndihmonit për të kompletuar projektin mbi dixhitalizimin e përkthimeve biblike e liturgjike të Nolit, e cila në pjesën dërrmuese është kryer prej nesh.

Është punë e përbashkët, ose më mirë, që bëhet vetëm për të tjerët, ku ne ofrojmë nga mungesat e jo nga tepricat, prandaj dhe shprejsoj se do të ketë edhe të tjerë që kanë dëshirë të përfshihen, duke ofruar disa orë punë vullnetare në javë, për të ringjallur punën e Fan Nolit.

Mbeten për të kaluar në skanner katër libra për botimet anglisht dhe vetëm dy libra për botimet shqip. Do t'a çmojmë shumë si ne, besoj edhe Noli, nëse disa dashamirës të kulturës shqiptare i skanojnë këto gjashtë libra dhe na i dërgojnë që t'i rendisim në faqet tona elektronike. Kjo është ndihma që ne kërkojmë.

Ata që janë të interesuar, ju lutem të kontaktojnë me ne, në detajet që shënohen në fund të këtij shkrimi, për të bashkërenduar procesin. Librat e Nolit ndodhen në shumë biblioteka në ShBA, si dhe në të gjitha kishat shqiptaro-amerikane, ku mund t'i huazojë çdokush e t'i fotokopjojë. Në të kundërt, jemi gati t'ua postojmë vetë tekstet të interesuarve.

Katër titujt e ardhshëm në anglisht, do të shtohen tek botimet në këtë gjuhë, të cilat po i rendis të parat në fund të këtij mesazhi, dhe dy librat që mbeten në shqip, do të ndërftohen në botimet shqipe.

Dy personat që ndihmojnë deri tani në projekt, parapëlqejnë të mos shënohen me emra, duke u nisur nga motive modestie, por është mirë që puna të shënohet me emër, sepse kështu do të ndihmojë në zgjerimin e bashkëpunëtorëve, sigurisht nëse nuk e kundërshtoni.

Në qoftë se kjo kërkesë-thirrje ju tingëllon e tepërt, ju lutem shpërnjiheni atë dhe ju kërkoj ndjesë.

Këtë projekt e nisëm me bindjen se rrezet e kulturës shqiptare duhen zgjeruar në Internet; secili në fushën e tij, por edhe duke bashkëpunuar në ato pika të pamohueshmërisë së përbashkët.

Faleminderit!

At Foti Cici

St. Astius Albanian Orthodox Church  
Kisha Ortodokse Shqiptare e Shën Astit  
tel. 416-533-0650, fax 416-533-0654  
[www.ShqiptarOrtodoks.com](http://www.ShqiptarOrtodoks.com)  
599-B Yonge Street, Suite 209  
Toronto ON, M4Y 1Z4, CANADA

#### Noli's Liturgical and Biblical Publications in English: 1949-1964

1. Orthodox Prayer Book, 1949
2. Liturgy and Catechism of the Eastern Orthodox Church, 1955
3. Byzantine Hymnal, 1959
4. Noli New Testament, 1961
5. The Poet of Nazareth, 1962
6. The Psalms, 1964

#### Botimet e periudhës I të Nolit: 1908-1914

1. Shërbes' e Javës së Madhe, 1908
2. Libër e Shërbesave të Shënata të Kishës Ortodokse, 1909
3. Libër e të Kremteve të Mëdha të Kishës Ortodokse, 1911
4. Triodi i Vogël (Java e Madhe), 1913
5. Pesëdhjetore e Vogël, 1914
6. Lutjesorja, 1914

#### Botimet e periudhës II të Nolit: 1941-1952

1. Uratore e Kishës Ortodokse, 1941
2. Kremtore e Kishës Ortodokse, 1947
3. Triodi dhe Pesëdhjetorja, 1952



Kolegë dhe miq të Alb-Shkencës,

nuk e di nëse ndonjëri prej jush mori pjesë në konferencën e XV-të ndërkombëtare Goldschmidt që këtë vit u mbajt në Moscow, Idaho, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga 20-25 maj 2005.

Kjo është konferenca vjetore më e madhe në fushën e gjeokimisë dhe mineralogjisë, në të cilën marrin pjesë studiues nga e gjithë bota. Ajo sponsorizohet nga shumë shoqata profesionale, ndër më kryesoret e të cilave janë: The Geochemical Society (of America), The Mineralogical Society of America, The European Association of Geochemistry, Mineralogical Association of Canada, The International Association of Geochemistry etj.

Për më tepër informacion rreth kësaj konference mund të vizitoni faqen elektronike në adresën:

<http://www.the-conference.com/2005/gold2005/index.php>

Unë mora pjesë për herë të parë në këtë konferencë në vitin 2001. Ndërsa këtë vit paraqita rezul-

tatet më të fundit eksperimentale të kerkimit shkencor që po bëjmë për të kuptuar si se ndodh dhe se cilët janë faktorët që ndikojnë në lëvizjen e uraniumit me valencë (+6) në sedimentet e ndotura me të.

Përveç procedurave të zakonshme laboratorike, ky studim kërkon përdorimin e disa aparaturave të kohës si X-ray microprobe, electron microprobe, laser-induced time-resolved fluorescence spectroscopy dhe scanning electron microscopy (nuk i di në shqip emrat e këtyre aparaturave dhe procedurave laboratorike; kjo është një arsye më tepër përse duhet që ti pasurojmë më tej fjalorthët terminologjikë në faqen e Alb-Shkencës në internet).

Përmbledhja e këtij prezantimi, ashtu si të gjitha prezantimet e tjera të konferencës, është botuar në numrin e fundit të revistës shkencore: *Geochimica et Cosmochimica Acta*.

Nëqoftëse jeni të interesuar unë mund t'iu dërgoj kopje të përmbledhjes si dhe mund t'iu përgjigjem pyetjeve eventuale rreth teknikave eksperimentale të përmendura më sipër dhe aplikimeve të tyre në shkencën e gjeokimisë.

Ju uroj gjithë të mirat,  
Niko Qafoku.

## Regjistri i parë botëror i ndotjeve nga Omgj-të

Greenpeace dhe GeneWatch publikuan këto ditë regjistrin e parë të ndotjeve nga Organizmat e modifikuar gjenetikiht:

[www.gmcontaminationregister.org](http://www.gmcontaminationregister.org)

Siti internet, me një motor kërkimi praktik, ofron detaje për të gjithë rastet e njohur të ndotjes së ushqimeve për njerëz e kafshë, farave e bimëve të egra në vende të ndryshme të botës.

“Asnjë qeveri apo agjenci ndërkombëtare nuk ka krijuar një regjister publik të incidenteve apo problemeve të tjera të lidhura me kultivimet Omgj. Nuk mund të mbyllësh sytë kur ke të bësh me bioteknologji si pasojë e të cilave kemi një lëshim të pakontrolluar organizmash të gjallë në natyrë” – thotë Federica Ferrario, zëdhënëse për Greenpeace.

Qysh nga futja e tyre në vitin 1996, Omgj-të kanë shkaktuar 62 incidente të lidhur me ndotjen nga Omgj ilegale ose pa etiketim, në 27 vende të botës. E këta janë vetëm incidentet të cilët janë bërë të njohur.

“Po japim sot këtë regjister ndërkohë që qeveritë takohen në Montreal për të vendosur mbi regjimin e përgjegjësive ndërkombëtare për kultivimet Omgj. Nëse nuk merren masa konkrete në këtë drejtim, Omgj-të do të dalin plotësisht jashtë kontrollit” vazhdon Ferrario.

Duke konsultuar regjistrin, shihet se numri më i madh i ndotjeve nga Omgj-të ka ndodhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (11 incidente). Ndotja nga misri “Starlink” është verifikuar në shtatë vende: ShBA, Kanada, Bolivi, Egjipt, Korea e Jugut, Japoni e Nikaragua.

Lëshimi ilegal i Omgj-ve në mjedis ose në vargun ushqimor ka ndodhur në Indi (pambuk), Brazil (pambuk e sojë), Kinë (oriz), Kroaci (misër), Gjermani (papaia) dhe Tailandë (pambuk e papaia). Në regjister jepen edhe gjashtë raste të efekteve anësore negative në bujqësi, përfshi edhe shpërndarjen e barëra-ve të këqija të qendrueshme ndaj herbicideve.

**Greenpeace**



dere të një hoteli, prej djalit të tezes, një kriminel i rendomtë Baltjon Stambolla. Për këtë vrasje u akuzua Ceno Beg Kryeziu, kunat i Ahmet Zogut, që vetë do të vdiste pak më vonë në një atentat në Pragë. Ndër të akuzuarit e kohës ishte edhe Ahmet Zogu, megjithëse nuk ka dokumenta, që e mbështesin një akuzë të këtillë përveç disa deklaramëve të ish konsullit shqiptar të asaj kohe në Bari. Pas rënies së qeverisë 6 mujore të Fan Nolit, Gurakuqi ishte emigrant në Itali, ku vite më parë kishte emigruar edhe ai që ngriti flamurin në Vlorë, Ismail Qemali.

Megjithëse saktësisht nuk dihet emri i sponsorizuesit të këtij atentati, dihet se antishqiptarizmi kreu një goditje të rëndë ndaj kauzës kombëtare me datën 2 Mars të vitit 1925 në derë të Hotel Cavour, në Bari të Italisë.

Në fund Ukcamaj, ripohoi pse e kishte pritur me kënaqësi pjesëmarrjen në këtë akademi përkujtimore shkencore: “Pranova me kënaqësi ftesën nga kisha Zoja e Shkodrës, për arsyen se besoj që ne shqiptarët e tashëm kemi nevojë për një histori selektive, në mënyrë, që t’u lemë brezave arsyen, se si arritëm të ekzistojmë si komb, të ëndërrojmë dhe të kemi shtet, cilat ishin parimet e larta, mbi të cilat u ngjiz identiteti ynë kombëtar dhe cilët ishin themeltarët. Në historinë tonë të vjetër dhe të re, janë pak burra apo gra, që mund të vendosën në paneonin e ndritur, ku ky vigan liberator, e vendosi veten me shërbesat, që i kreu ndaj popullit të vet”.

Në pjesën e dytë të akademisë përkujtimore, mbi jetën dhe veprën e Prof. Ernest Koliqit foli aktivisti i mirënjohur i komunitetit shqiptaro-amerikan Dr. Gjon Buçaj, aktualisht n/kryetar i Federatës Panshqiptare Vatra (1912) me qendër në New York, mësues i gjuhës shqipe pranë Qendrës Nënë Tereza. Ndryshe nga referuesi i parë, që kishte vjelur dokumente, për ta bërë punimin shkencor mbi Luigj Gurakuqin më interesant, Dr. Buçaj, risolli të freskëta kujtime origjinale, si bashkëveprimtar në takimet e shpeshëta, që ka pasur me Prof. Koliqin në Itali e ShBA. Ai theksoi se: “Arsyeja, që unë i jam përgjigjur pozitivisht ftesës me marrë pjesë sot këtu, është që të flas shkurtimisht disa shënime që unë i kam hedhur mbas shumë kujtimeve që kam për këtë burrë të madh të nacionit tonë, që e kemi dashur dhe e duam”.

Dr. Buçaj, rrëfeu para auditorit kujtime personale me Koliqin, të dëgjuar prej tij dhe takimet mes miqve, pa u thelluar shumë në analiza letrare të veprës që shkroi. “E kam njohur Prof. Ernest Koliqin në vitin 1965, kur unë mbërrita në Itali. Më ka njoft me të Kolë Bibë Mirakaj dhe gjatë viteve 1965-1974, kam pas kënaqësi tatakuj shumë herë. Kjo është veçanërisht merita e tij, sepse ai ka pas

dëshirë me bisedue, me kalue, me transmetue të gjitha mendimet e veta tek të rinjtë. Ai ka nënshkruar dokumente me rëndësi shkencore si diplomat e studentëve të universitetit, kandidatë që më vonë janë bërë doktora; dokumente politike, sikurse është Protokollu i Aleksandrisë etj.

Koliqi lindi në një familje atdhetare dhe tregtare të njohur shkodrane. Pjesën më të madhe të jetës ai e kaloi në Itali pasi në vitin 1918, i ati e ka dërgue atje me ndjekë kolegjin në Brescia (studimet e larta, ku student ishte edhe papa i ardhshëm Pali VI, mik i Koliqit). Poezitë e para, i shkroi në gjuhën italiane, ku bënte pjesë në një klub letrar bashkë me të rinj italianë, shkrime të botuara në gazetën *Ne të rinjtë*. Në vitin 1921 kthehet në Shqipëri e më 1924 bashkëpunon në gazetën letrare *Ora e maleve*, së bashku me padër Anton Harapin, Nush Topallin etj. Merr pjesë në rrethin letrar të kohës me shumë të rinj të tjerë, që më vonë do të bëheshin emra të mëdhenj të kulturës e letrave shqipe si: Prof. Karl Gurakuqi, Kol Thaçi, Dom Lazër Shanto, Loro Ashiku, Lin Kamsi etj. Koliqi, ka fituar konkursin për tekstin e hymnit kombëtar të Shqipërisë, të shpallur prej Ministrisë së Arsimit, ku autorët ishin anonimë. Juria përbëhej nga padër Gjergj Fishta, imzot Fan S. Noli dhe Mit’hat Frashëri. I inkurajuar, prej Luigj Gurakuqit, ai shkroi, poemën e titulluar: “Kushtrimi i Skanderbegut”. Në vitin 1924, për arsye politike, ai bën pjesë në anën e opozitës bashkë me Nolin. Koliqi, gjatë emigracionit 5 vjeçar në Tuzllë të Bosnjës u njoh me shkrimtarë serbo-kroatë, duke vijuar kështu veprimtarinë letrar dhe patriotike, duke ruajtur lidhjet me vendin e tij dhe personalitetet e shquara që ishin në opozitë dhe jetonin jashtë shtetit.

Në vitin 1943, kthehet në Romë, ku punoi si profesor univesiteti. Më 1957 u krijua Insituti i Studimeve Albanologjike meritë e Koliqit dhe bujarisë së presidentit të Italisë Antonio Segni. Po këtë vit, ai themelon gazetën *Bloku independent* ku është shkruar në shqip, italisht, frengjisht dhe anglisht. Disa nga shkrimet me vlerë të kësaj kohe janë *Dy shkollat letrare shkodrane*, libreti *Tangjelet e Rilindjes*, romani *Shija e bukës së mbrumë*. Botoi edhe ekstrakte të vogla për Ded Gjon Lulin, D’Annunzion, kumtesat që ka mbajtur në konferencat kulturore në Spanjë, Turqi etj. Po këtë vit, filloi botimin e revistës *Shejzat* (1957, Itali). Botoi një monografi *Albania* (rreth 150 faqe), enciklopedi të Europës, ku ai shkroi për Shqipërinë në mënyrë objektive; ribotoi *Simfonia e shqipeve* ku vuri në dukje vlerat etike, historike të prejardhjes së kombit shqiptar. (*Shkrimin e plotë mund ta gjeni në adresën <http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca>*

**Klajd Kapinova**



## BURSA PER GAZETARE TE RINJ

European Cultural Foundation fton gazetarët e rinj nga Europa Qendrore, Lindore dhe Juglindore të aplikojnë për bursë studimi që do tu japë mundësi atyre që të realizojnë një projekt gazetarie me temë një vend europian të ndryshëm nga ai i origjinës së tyre.

### KRITERET

1. The journalist should be under 35 years of age and from one of the following countries: Albania, Bulgaria, Bosnia & Herzegovina, Croatia, Czech Republic, Estonia, former Yugoslav Republic of Macedonia, Hungary, Latvia, Lithuania, Malta, Poland, Romania, Serbia and Montenegro, Slovakia, Slovenia and Turkey.

2. Individual young journalists should apply in conjunction with the editors-in-chief or section editors of weeklies or weekly supplements. Editors must provide a written statement indicating that they are willing to publish the article (or series of articles) by the young journalist in question.

3. The project proposal must contain the following items:

- a. Clearly formulated topic(s) and/or question(s) for investigation
- b. Relevance of these topics/questions within the European context
- c. List of places and people to be visited/researched during the project
- d. The preferred timeline of the travel/research
- e. The preferred local partners/hosts (newspapers, agencies, institution) where the research

will take place

f. Preliminary budget for the overall realisation of the project including the financial contribution of the newspaper.

4. The proposals should be sent before the deadline 31st October 2005

For the chosen project proposals, the European Cultural Foundation, in collaboration with its partners, will provide:

a. A grant for the project's realisation, up to the amount of 2,500 euro, given in two instalments (first: 80%, second: 20%)

b. Further network support in the destination country, in terms of residency arrangements and relevant contacts (both personal and institutional)

c. Further translation/promotion/dissemination of the work of the selected journalists throughout the ECF network and beyond, following publication of the original article(s).

All project proposals should be submitted to the following address:

Media Programme European Cultural Foundation

Jan Van Goyenkade 5\1075 HN Amsterdam  
The Netherlands

Further inquiries:

Coordinator of Closer Look Ms Eva Karadi  
[ecf.karadi@axelero.hu](mailto:ecf.karadi@axelero.hu)

Coordinator of the European Cultural Foundation's media programme Mr Tommi Laitio  
[tlaitio@eurocult.org](mailto:tlaitio@eurocult.org), +31.20.573.3868

**Agron Alibali** ([agron@rcn.com](mailto:agron@rcn.com))

## Qendrushmëria ndaj barit mjekësor kundër Hiv më e lartë se parashikimi

Qendrushmëria ndaj një bari mjekësor anti retroviral mund të jetë më e lartë se parashikimi. Këto janë përfundimet e tre studimeve të publikuar në numrin e fundit të revistës *Journal of infectious diseases* që kanë të bëjnë me nevirapinën, bar që përdoret për të penguar transmetimin e virusit Hiv nga nëna tek fëmija.

Dy studimet e para vlerësuan qendrushmërinë ndaj këtij bari mjekësor në bazë të disa testeve më të ndjeshëm se sa ata që përdoren normalisht. Nga këto kërkime doli në pah se qendrushmëria ndaj

një doze të vetme navirapine manifestohet në 65 për qind të grave të trajtuara me të kur deri tani mendohej se ishte 40 për qind.

Studimi i tretë tregoi se qendrushmëria shfaqet më shpesh në ato gra të infektuara me një nëntip të veçantë virusi, ai C që është shumë i përhapur në vendet e prapambetura e ato në zhvillim, në krahasim me dy nëntipat e tjerë A dhe D, që janë më pak të pranishëm.

**Journal of infectious diseases**



## LETRA • LETRA • LETRA

**D**ëshiroj të di nga ju se ç'farë kushtesh duhen për të hyrë në një nga universitetet e mjekësisë në Britaninë e Madhe dhe ku ndodhen këto universitete. Po patët mundësi më dërgoni disa adresa elektronike në lidhje me këto universitete. Ju përgëzoj për punën e madhe që po bëni.

Klodian Shahu (evolutionklodi@hotmail.com)

I nderuar Klodian,  
për pranim në universitete britanike duhet së pari zotërimi i gjuhës angleze. Pastaj sukcesi yt i deritashëm. Kualifikimet nga shkolla e mesme kërkohet të jenë ekuivalente me ato të Anglisë.

Secili universitet në Britani ka të dhëna të bollshme mjafton të kërkosh për international students ose overseas students. Më pas mund të aplikosh dhe të shohësh se ç'farë do të thonë.

Pagesat universitare për studime mjeksore janë nga më të lartat. Nëse mendon të vetë financohesh atëherë të nevojitet një shumë relativisht e madhe parash.

Lista e 10 universiteteve më të mira për mejkësinë në vitin 2005 në Britaninë e madhe e marrë nga *Guardian Education* janë:

- 1.Imperial College,London, England  
<http://www.imperial.ac.uk>
- 2.University of Hull, Hull, England  
<http://www.hull.ac.uk>
- 3.University of Oxford, Oxford, England  
<http://www.ox.ac.uk>
- 4.University College London, London, England  
<http://www.ucl.ac.uk>
- 5.University of Manchester, Manchester, England  
<http://www.man.ac.uk>
- 6.University of Dundee, Dundee, Scotland  
<http://www.dundee.ac.uk>
- 7.University of Cambridge, Cambridge, England  
<http://www.cam.ac.uk>
- 8.University of Cardiff, Cardiff, Wales  
<http://www.cardiff.ac.uk/index.html>
- 9.King's College, London, England  
<http://www.kcl.ac.uk>
- 10.Queen Mary, London, England  
<http://www.qmw.ac.uk>

Për informata të mëtejshme vizitoni faqen e *Guardian Education*.

<http://education.guardian.co.uk/universityguide2005/table/0,15905,-5163909,00.html>

Suksese ne angazhimet tuaja  
Mehmet Shala

## PUBLIKIME SHITES NE LISTEN E PUNIMEVE SHKENCORE 2004

Listës së botimeve shkencore të vitit 2004, e cila është e afishuar në faqen e Alb-Shkencës në internet ([www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org)) iu shtuan së fundi edhe punimet e zotit Besnik Pula të cilat janë si më poshtë:

Pula, Besnik: *The emergence of the Kosovo "parallel state", 1988-1992*, Nationalities Papers, December 2004, vol. 32, no. 4, pp. 797-826.

Pula, Besnik: *A Changing Society, a Changing Civil Society: Kosovo's NGO Sector after the War*, Kosovo Institute for Policy Research and Development, Policy Study #3 (July 2004).

### PREZANTIME:

*The emergence of the Kosovo "parallel state", 1988-1992*, prezantuar në "Political Science and Society - Challenges of Democratization, Development and European Integration, Albanian Political Science Association (Tirana, Albania), November 2004.

*Social Instability and Ethnic Violence: The Need for a Renewed Western Commitment to Kosovo*, prezantuar në "Kosovo Five Years After: What Agenda for the Future?" (Prishtina, Kosovo), July 2004.

*Can Knowledge Be National? Institutions, Knowledge, and the Nation*, prezantuar në "Association for the Study of Nationalities", Ninth Annual World Convention (New York, NY), April 2004.

## SHTETI MASHKULLOR DHE GRATE

Që shteti shqiptar është një shtet mashkullor, kjo them se nuk ka shumë nevojë për dëshmim. Politika më e lartë e tij, por edhe nivelet e mesme drejtohen nga burrat. Gratë, edhe nëse ndonjëherë mbulojnë poste nominalisht të rëndësishme, asnjëherë nuk kanë dorë e personalitet të lirë në vendimmarrje, çka është edhe treguesi kryesor i peshës që ato do të kishin në politikë e në shtet.

Por nuk janë vetëm postet e dukshme pushtetshtruese (kryeministër, ministra të ministri-ve kyçe, kryetarë bashkish, kryetarë gjykatash të larta etj.), ato që dëftojnë mashkullorinë (jo burrërinë) e shtetit tonë. Mashkullore janë edhe strukturat e padukshme të qeverimit, lobet, klanet, zotëruesit e parasë së madhe, ata që shpesh përcaktojnë edhe veprimet e politikanëve tanë ah, sa pak të pavarur.

Më tej, mashkullor është krejt toni i politikës dhe i shtetit. Ata që e japin këtë ton qysh prej vitit 1991 janë të fortët, bërtitësit, sharësit, përdoruesit e një gjuhe të rreptë agresive e deri fashiste, të ngjashëm me personazhet e filmit *Nëntëqinta (Novecento)* të Bertoluccit, gjuhë e vrazhdë arrestuesish e burgaxhinjsh, satanajsh e ëngjëjsh demagogë të lyer me zift, një gjuhë që kurrsesi nuk mund ta presësh nga goja e një femre të qytetëruar në fillim të shekullit XXI.

Nuk është nevoja të jap shembuj konkretë të kësaj lloji gjuhe; sillni ndër mend vetëm disa seanca të famshme parlamentare, sikurse kanë qenë komisionet hetimore, ato të deklarimit të pasurive, ndiqni fushatën zgjedhore që po kalë-rojnë krerët e partive të mëdha këto ditë, mejdane të përgjakshme të fjalës dhe orgji balte në drejtim të kundërshtarëve, mes të cilave nuk mund të kalojë jo më vetëm një femër politika-ne e kultivuar, por as dhe një mashkull me hijen më të lehtë të finesës civilizuese në kostumin e tij.

Ndryshe është gjendja në shoqërinë e ngritur shqiptare, po të krahasohet me këtë tablo të qeverimit tonë. Gra e vajza të reja, të mençura e të kultivuara, ndesh në çdo hap, në institute e në banka, në fondacione e përfaqësi ndërkombëtare, në shoqërinë civile, në shkolla apo klinika private etj., etj. Ato e flasin anglishten si të jenë kthyer dje nga Oksfordi, ato janë të afta të kryejnë çfarëdolloj masteri brenda e jashtë vendit, më të mirat e tyre do të mundnin të ndi-

qnin karriera të shkëlqyera universitare, shkencore, politike... Do të mundnin; për fat të keq, foljen e kam vendosur në mënyrën kushtore.

Sepse realisht nuk mundin. Universitetet tona kanë në shumë pika erën e rëndë të mykut që ka edhe politika shqiptare (pale tani që kanë dalë edhe këtu të fortët, rektorët që po kandidojnë për në Parlament), femrat e civilizuar e të kultivuara që përmenda, në kushtet e varfërisë dhe të mashkullorisë mbisunduese të fakulteteve tona asfiksohen. Prandaj edhe mundësia e vetme e jetesës dhe karrierës dinjitoze për këtë racë të brishtë në gjirin e grave shqiptare, e cila ka natyrisht, në mënyrën e saj, forcën e vet, mbeten fondacionet, zyrat e të huajve, institucionet me pavarësi relative nga shteti, shkollat e klinikat e reja private.

Është vërtet e habitshme, por në majat e tij shteti ynë, me mashkullorinë që e karakterizon, ngjan shumë më tepër me një shtet fondamentalist fetar sesa me një shtet evropian. Edhe pse politikanët shqiptarë janë ateistë, desha të them pa besë, desha të them jo besimtarë praktikantë, me përjashtimin që u bëjnë femrave nga sferat e larta vendimmarrëse, sillen si sheikë e imamë me pushtet.

Ndokush do të thotë: po ata kanë femra në gjirin e partisë së tyre, nganjëherë bile edhe të hijshme e të kultivuara në dukje. Pse nuk i përfill? Po, vërtet kanë, mirëpo sa hapin gojën këto gratë e politikës sonë, fillojnë e flasin *to idhjo* si shefi i partisë së tyre; ku është atëherë personaliteti i tyre? Përse duhet ta hapin gojën tek e fundit?

Janë disa shkaqe që pengojnë formimin e personalitetit të gruas politikane e gruas së shtetit tek ne: në radhë të parë, është shoqëria dërrmueshëm mashkullore (të mos gënjehemi nga zona e Bllokut). Shumica e burrave presin nga gratë gatimin dhe fëmijëmbajtjen, pastrimin dhe psonisjen: fare të paktë mund të jenë ata që teorikisht do t'i linin bashkëshortes kohën e duhur për të bërë një karrierë politike dhe që kanë ndonjë dëshirë të zbatojnë parimin e natyrshëm të barazisë: barazi shansesh, barazi kohe të investuar në familje e në shoqëri.

Një shkak tjetër është mënyra se si shihet gruaja, e sidomos gruaja e re, në çastin që kjo hyn për një karrierë në shtet e në politikë, nga mashkulloria rrethuese. Pa vonesë ajo do të kalojë nëpër vështrime, vërejtje dhe veprime seksiste. Një mashkull shqiptar në politikë, sidomos ç'janë 40 vjeç e lart, e ka të vështirë në

mos të pamundur, të komunikojë me personalitetin e një gruaje të re, të themi me pamje të rregullt deri të hijshme, duke lënë jashtë ngacmimet erotike. Kjo i vjen nga uria e trashëguar, por edhe nga një vetëdije e çuditshme se epërsia që ka në peshë ose në ngritje mobiljesh, është vetvetiu epërsi në gjithçka ndaj saj, duke i lejuar vetes vërejtje seksiste, ndërkohë që ajo kurrë nuk do të bënte të anasjelltën.

Ky raport i çuditshëm ka krijuar edhe dy lloje femrash në politikë a në drejtim tek ne: në një anë drejtuesen (jo vendimmarrëse!) që nuk rrezaton më asnjë emetim erotik, në anën tjetër drejtuesen që bën përpara vetëm ose kryesisht përmes emetimeve erotike. Të parën e kemi njohur që nga koha e Enver Hoxhës: drejtuesja socialiste, e cila ta dëbonte çdo libido edhe vetëm me kostumin bezhë terital dhe jakën e bardhë të këmishës përmbi xhakëtë: kulmin e karrierës kjo grua e arrin në proporcion të drejtë me kulmimin e mashkullorisë që bart në vetvete. Ndërsa e dyta ka dalë më fort në dukje në kohën e re: gra karriere që i përshtaten urisë përreth dhe e përdorin atë për karrierën e tyre. Nuk është e thënë doemos që të kryejnë adulter; u mjafton që t'u japin meshkujve të fuqishëm, me të cilët duhet të punojnë a nga të cilët duhet të kalojnë, përfytyrimin se ndoshta edhe do të ishin gati t'i përgjigjeshin gjakimit të tyre (të transmetuar me qindra sinjale), sikur...

Natyrisht që një rrugë e tillë fsheh në vetvete rreziqe dhe mund të të shpjerë deri në njëfarë vendi, por jo më tej. Por a ka ndonjë rrugë tjetër drejt ngritjes së personaliteve politike femërore përveç asaj të çfemërizimit dhe të seksualimit? Natyrisht që ka, madje ato femra që do të dëshironin rritjen në politikë dhe në vendimmarrje në Shqipëri, as nuk do të duhej t'i përfillojnë fare këto dy hulli komiko-tragjike që i ofron gruas mashkulloria e politikës sonë sot. Vetëm se kjo s'mund të vijë as me shprehje dëshirash, as me ëndërrime modelesh evropiane: them se gruaja mund ta arrijë dinjitetin e duhur tek ne në po të njëjtën mënyrë siç do ta arrijë këtë dinjitet krejt shoqëria shqiptare: me përtëritjen e saj dhe me largimin e specisë së vjetëruar që na angështon nga të gjitha frenat e politikës dhe niveleve të tjera të larta të vendimmarrjes.

**Ardian Klosi**

## FILLOJNE APLIKIMET PER PROJEKTIN "PRAKTIKA 2005"

Të dashur studentë,

që prej 15 vjetësh kur Shqipëria u bë tashmë një vend i hapur me botën një numër përherë e më i madh të rinjsh nisën të zgjedhin vendet perëndimore për të kryer studimin e tyre. Studentët shqiptarë janë tashmë ndër më të pranishmit kudo në Europë dhe në Amerikën e Veriut. Ata përbëjnë sot një nga shpresat më të mëdha të vendit për të ardhmen. E gjithë përvoja dhe dija që ata po grumbullojnë në universitetet më të mira të botës, nëse do të praktikoheshin në Shqipëri, do t'i jepte vendit një impuls të jashtëzakonshëm zhvillimi. Kjo për shkak edhe se studentët shqiptarë kanë provuar gjithandej ku kanë studiuar, se radhiten ndër më të aftët dhe kompetitivët. Ky kapital kaq i madh intelektual, do të ishte boomi i vërtetë i zhvillimit të vendit. Fatkeqësisht, pas disa vitesh në perëndim, shumë të rinj shqiptarë, i shkëpusin lidhjet me vendin e tyre duke humbur çdo kontakt me vështirësitë që ai kapërcen apo edhe me lehtësitë e reja që hapen përditë për të arsimuarit jashtë dhe mundësitë që ata të zbatojnë në mënyrë të dobishme por njëkohësisht edhe fitimprurëse për ata vetë, dijet e tyre në shtëpinë e tyre.

Në këtë kontekst Rrjeti Internacional i Shoqatave Studentore Shqiptare Albstudent ([www.albstudent.net](http://www.albstudent.net)) dhe Mjaft Foundation ([www.mjaftfoundation.org](http://www.mjaftfoundation.org)) kanë filluar së bashku projektin "Praktika 2005" nën moton "Hapësira rikthimi". Projekti mundësohet nga mbështetja e Ambasadës Gjermane në Tiranë në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe nga Ministria e Kulturës Rinisë e Sporteve. Ky projekt inovativ do të shërbejë për të organizuar kthimin në atdhe të studentëve të talentuar që studiojnë jashtë, duke u dhënë atyre mundësinë të njohin realitetin e punës në institucionet shtetërore e firmat e mëdha shqiptare duke kryer praktika në to e duke u dhënë mundësinë të zhvillojnë aftësitë e tyre akademike duke i zbatuar ato në praktikë. Ne po ndërmjetësojmë në mënyrë të suksesshme me shumë institucione qendrore shqiptare apo kompani nga më të mëdhatë në vend, që ato të çelin dyert për studentët në perëndim për të kryer praktikën në Shqipëri. Të gjitha informacionet rreth këtij projekti si përshtetja e praktikave, mundësia e aplikimit online, organizatorët, mbështetësit etj, ju mund t'i gjeni tek faqja [www.praktika-online.com](http://www.praktika-online.com). Kjo faqe do të pasurohet vazhdimisht në javët e ardhshme me informacione mbi vende të reja praktikash etj.



## FALENDERIM DHE MIRENJOHJE DOKTOR SELAHEDIN VELAJT

Ditët e fundit Prof. Dr. Selahedin Velaj, i njohur nga komuniteti shqiptar i Amerikës si një intelektual i shquar, përkrahës dhe aktivist i flaktë i çështjes shqiptare, një ndër emigrantët e hershëm politikë në ShBA, të cilit regjimi komunist shqiptar pothuajse i shoi gjithë familjen, i ka dhuruar këtij komuniteti një dokument të rëndësishëm dhe të vlefshëm, broshurën me titull *Testamenti*.

Me këtë broshurë duke ua shpërndarë falas gjithë shqiptarëve, shoqatave jo fitimpruese dhe institucioneve fetare në ShBA, Dr. Velaj ka si qëllim t'iu theksojë lexuesve rëndësinë që ka testamenti, për kalimin e pasurisë tek trashëgimtarët, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat punojnë dhe jetojnë emigrantët shqiptarë e duke u bazuar në përvojën e tij të gjatë e të vështirë si emigrant.

Kjo broshurë, e para e këtij lloji, jep shpjegime të hollësishme të ligjeve federale dhe shtetërore amerikane që kanë lidhje me testamentin, i cili për ne shqiptarët është fare i panjohur.

“Eshtë e këshillueshme, – thotë autori, – që lexuesit t'i kushtojnë kësaj çështjeje vëmendjen që meriton dhe ta diskutojnë edhe me miqtë e shokët e tyre”. Më tej autori sugjeron që të jemi të kujdeshëm e të mos mashtrohemi duke firmosur dokumente që nuk i kuptojmë e që janë shkruar me qëllim grabitjen e pasurisë. Për këtë, në libër jepen shembuj të ndryshëm, ku shumë shqiptarë kanë qenë viktimat të mashtrimit.

Doktori i nderuar Selahedin Velaj megjithëse shumicën e jetës e ka kaluar në emigracion, mendjen dhe zemrën e ka patur dhe e ka tek atdheu i tij amë, Shqipëria, dhe tek populli i tij i vuajtur. Ai dhe bashkëshortja e tij këtë dashuri kanë ditur t'ua transmetojnë e ta mbajnë gjallë tek dy djemtë e tyre, Leka dhe Drini. Ka qenë kjo dashuri për atdheun që shtyu Drinin t'i dhuronte spitalit të Vlorës, qytetit nga e ka prejardhjen edhe familja e tij, aparatit e skanerit për sëmundjet e kokës si dhe një shumë të madhe barnash, që kapin shifrën prej disa mijëra dollarësh, edhe pse kolegët e tij shqiptarë nuk e morën as mundimin t'i kthenin përgjigje, të paktën për korrektësi në shenjë falenderimi.

Dr. Selahedin Velaj është gjithmonë i pranishëm në mes të shqiptarëve të Amerikës edhe me shkrimet e tij të shumta për çështje të ndryshme që botohen në ShBA. Falenderojmë nga zemra këtë njeri me shpirt të gjerë për gjithçka ka bërë dhe bën për shqiptarët dhe çështjen shqiptare, duke i uruar jetë të gjatë dhe shëndet të plotë.

*Pierre-Pandeli Simsia*

## SHKRIMET SHKENCORE VS. SHKRIMEVE POLITIKE

Kolegë dhe miq të Alb-Shkencës, edhe unë do të kisha shumë dëshirë që në listën e forumit tonë të Alb-Shkencës të shkruhej më tepër për shkencën dhe arsimin si dhe për mundësitë e bashkëpunimit midis studiuesve shqiptarë. Pa dyshim, ky është qëllimi parësor i këtij forumi në internet dhe nuk e kuptoj përse shkrime të tilla nuk janë aq të shpeshta në këtë forum.

Ndoshta ia vlen ta diskutojmë këtë problem si dhe të mundohemi që përveç konstatimit të japim ide konkrete si ta përmirësojmë këtë aspekt të veprimtarisë së forumit tonë. Mendimi im është që ky problem nuk zgjidhet nëpërmjet censurimit (apo siç e quajmë tani moderimit) të listës. Ai zgjidhet me rritjen e sasisë së shkrimeve divulgativo-shkencore si dhe me pjesëmarrjen e sa më shumë anëtarëve të Alb-Shkencës në diskutime për shkencën dhe arsimin të cilat nuk kanë munguar në të kaluarën.

Përsa i takon problemit që po diskutohet tani rreth qëndrimeve të lobit grek në Amerikë, unë mendoj që na takon të gjithëve të mbajmë qëndrim dhe të ngremë zërin tonë rreth këtyre pretendimeve pa bazë të grekëve. Alb-Shkenca duhet të dalë me një deklaratë të sajën rreth këtij problemi, të shkruar në atë nivel që i përshtatet forumit tonë.

*Niko Qafoku*

### Test gjenetik në fetuse pak javësh

Studiuesit australianë arritën të marrin një qelizë fetusi nga mukoza uterine dhe ta analizojnë për të identifikuar anomali gjenetike të mundshme të foshnjes brenda 7-10 javëve të para të jetës.

Testi i vënë në praktikë nga Mandy Katz-Jaffe i Monash University në Melburn dhe i përshkruar hollësisht në organin *BJOG*, një revistë ndërkombëtare e ostetrikës dhe gjinekologjisë, lejon kryerjen e analizës gjenetike të foshnjes qysh në javën e dhjetë të shtatzanisë.

Testi duket veçanërisht i përshtatshëm për individualizimin e sëmundjeve kromozomike siç është sindromi Down.

Por, edhe pse testi duhet të vihet plotësisht në praktikë, sipas studiuesve ai mund të përdoret edhe për dallimin e anomalive të karakterit gjenetik e jo vetëm kromozomik të foshnjes qysh në fetus.

*Reuters Health*